



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

Njoftim paraprak përqendrimi

Rasti: Përfitim kontrolli Alpha Bank S.A - Emporiki Bank of Greece S.A

Në datën 13 Dhjetor 2012, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar në bazë të marrëveshjes për shtijen e aksioneve e nënshkruar midis palëve Alpha Bank S.A dhe CreditAgricole S.A, më datë 16 Tetor 2012, me objekt përfitim, nga Alpha Bank S.A, të kontrollit të Emporiki Bank of Greece S.A nëpërmjet përfimit të masës prej 100% të kapitalit aksionar në këtë të fundit.

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- **Alpha Bank S.A:** është një insitucion financiar i listuar në bursën e Athinës, i cili ofron një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare të interguara duke përfshirë shërbime bankare për individë, për korporata, investime etj;
- **Emporiki Bank of Greece S.A:** është një institucion krediti i listuar në bursën e Athinës. Ajo është aktive në tregjet greke dhe ndërkombëtare të parasë dhe të kapitaleve, duke ofruar një rrjet të gjerë shërbimesh bankare tradicionale e moderne, dhe produkte për kursim, investim dhe financim etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b) dhe 12, pika 1 të Ligjit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al